

Kosova: Letërsia metatekstuale

Vehbi Miftari*

Përmbledhje

Objekti i tekstit *Kosova: Letërsia metatekstuale* është kritika letrare e zhvilluar në Kosovë, si pjesë e kritikës letrare shqipe dhe, më tej, e letërsisë shqipe përgjithësisht. Prandaj, përcaktuesi ambiantal “Kosovë” nuk synon të prekë statusin e letërsisë shqipe, sa format e saj, duke i theksuar tiparet e përbashkëta, po aq sa edhe veçantitë e zhvillimit të saj.

Sikur dihet tashmë, konteksti në të cilin u zhvillua kritika letrare në Kosovë, sidomos gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, është i ndryshëm nga kontekstualiteti i kësaj letërsie në Shqipëri, megjithëse edhe ajo mbetet, deri nga fundi i viteve '60, e lidhur me të, sado në trajtë të zbutur. *Tekstualiteti* i saj, ndërkaq, prek tipa, forma e metoda, sikur edhe zhanre e diskurse të ndryshme. Ajo e njuh kritikën akademike e kritikën e shkrimtarëve, deri dhe projektin kritik, si forma të kritikës. Kërkimi ynë këtu i njuh dhe i kërkon *modele*t dhe autorët përfaqësues, duke nënkuptuar me ta një numër tekstesh dhe autorësh.

Fjalët kyç: modeli himnizues, modeli kritik, vetëdija moderne për kritikën, kontekstualiteti e tektualiteti i kritikës, format dhe metodat, autorë e tekste themelore.

Letërsia metatekstuale shqipe (Kontekstualiteti e tekstualiteti)

Modernizmi (*zanafillor* dhe jo ai që, për shkaqe metode, po e quajmë kushtimisht *modernizëm transcendent*) në letërsinë shqipe, është kapërcim nga *literatura e himnizimeve* nacionale në *letërsi kritike*, para së gjithash në tekstet kritike e satirike të Faik Konicës. Rrjedhimisht, ajo i transformon shenjat e kërkimit nacional në atë të individit, por duke mbetur përgjithnjë e

* Dr. Vehbi Miftari, Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë, Universiteti i Prishtinës, Republika e Kosovës, vmiftari@gmail.com

lidhur me situatat jetësore që nisin të projektohen si situata personale e përfundojnë jo rrallë (si shtrirje) në projeksione nacionale.

Kontekstualiteti i kritikës letrare shqipe, në zanafillë të saj, ndërlihet me një ndërmarrje kulturore e me projektin kulturor nacional. Si *vetëdije* ajo lidhet me ermin e Faik Konicës, i cili propozonte një *të mirëfilltë kritikë letrare*, duke e parë atë pjesë të programit kulturor për nacionin. Kritika letrare shihej në atë kohë e ndërlihur ngushtë jo vetëm me një prodhimitari letrare, por edhe me një ambient kulturor.

Kritika metatekstuale shqipe e viteve '50, bashkë me ideologjinë rrafshuese komuniste si program, solli dhe rikthim në konceptin social, të njohur për letërsinë shqipe të viteve '30, në variantin më të papërshtatshëm për të, në kritikën e tipit socrealist. Në vitet '30, një numër i shkrimtarëve shqiptarë, Petro Marko, Nonda Bulka, Selim Shpuza, Vangjel Koça, Dhimitër Shuteriqi etj., ishin mbledhur përreth gazetës "Bota e re", e cila botohej në Korçë dhe përhapte idetë sociale për letërsinë. Ky grup i krijuesve, shpallte idetë e reja për letërsinë, duke u përpjekur që t'i kodifikonte më tej në dije teoretizuese për të. Kodifikues teorik i kësaj metode ishte Dhimitër Shuteriqi, i cili jo vetëm e artikuloi teorikisht kërkesën për një rol utilitar të letërsisë, por e ndërtoi edhe teorinë e parë të metodës: funksionin shoqëror si premisë të pashmangshme për letërsinë. Kjo kërkesë solli përpjekjen për kodifikimin e një drejtimi të ri letrar, i cili do të ndërtonte kornizën teorike për një letërsi qëllimore. Ai shkroi tri tekste teorike, në të cilat u përpoq të argumentonte teorinë e propozuar prej tij të metodës: *Drejtimit e rea letrare*,¹ *Prap mbi drejtimit e rea letrare*,² si dhe tekstin *Për një drejtim letrar*.³ Tekstet e pasojnë, madje e plotësojnë teorikisht njëri-tjetrin. Ato dalin si *tekste argumentuese*, njësoj sikur dalin edhe si tekste me premisa teorike për metodën. Në këto tekste, ai e ndërtoi teorinë e tij për metodën realiste shkallë-shkallë, duke shtruar po kështu edhe

¹ Botuar në „Bota e re“, Korçë, 1936, nr. 4, fq. 7-9.

² Po aty, 1936, nr. 6, fq. 9-11.

³ *Përpjekja shqiptare*, Tiranë, 1937, nr. 8, fq. 100-103.

kërkesën e tij për një funksion shoqëror të letërsisë e vetëdijen për të si prodhim shoqëror.

A mund të ketë kritika letrare e zhvilluar në Shqipëri në vitet '50 e tutje ndonjë lidhshmëri me një tip tepër të njohur dhe tej mase të frytshëm në letërsinë dhe në kritikën letrare shqipe të viteve '30? Mendoj se konteksti i zhvillimit të letërsisë shqipe, sidomos pas përfaqimit të asaj që Dhimitër Shuteriqi e shpallte si program, "kritikën e realizmit socialist", si dhe veshja e tij me ideologjinë komuniste si ideologji për literaturën, krijuan një trajtë të letërsisë si dhe një letërsi kritike të njëtrajtshme, e cila u shtri hiq më pak se për 50 vite në Shqipëri, kurse deri nga fundi i viteve '60 edhe në Kosovë, por në formë tjetër, sikur do të argumentohet më poshtë.

Letërsia metatekstuale shqipe në Kosovë, ndërkaq, u zhvillua në kontekst të ndryshëm *sociopolitik* dhe *sociokulturor* nga ajo e zhvilluar në Shqipëri,⁴ megjithëse deri nga fundi i viteve '60 edhe ajo mbetet e lidhur me "teorinë e realizmit socialist", sado në trajtë të zbutur.

Tekstualiteti i saj, ndërkaq, prek tipat, zhanret e diskurset e ndryshme, për të provuar një përpjekje të konsolidimit të metodës. Në këtë kohë shfaqen edhe tekstet e para kritike, të cilat në kuptimin e formave njohin *kritikën akademike*, e *kritikën e shkrintarëve*, deri edhe *projektin kritik*, me **Mitrush Kutelin** e me **Krist Malokin**. Po ashtu, në këtë periudhë u shfaqen metoda të veçanta të kërkimit kritik, *kërkimi tematologjik e psikanalitik* (**Maloki**)⁵, *kërkimi imanent* që dëshiron të mbetet te format (**Kuteli**), *kërkimi i esencave letrare* (**Pipa, Draçini**), *kërkimi me parabazë sociale* (**Noli**) etj.

Kosova: Letërsia metatekstuale (Vetë-dija kritike)

Mendimi kritik letrar dhe vetë-dija për kritikën, e ndërlidhur me shenjën e përkatësisë ambientale, e shpie kërkimin tonë deri te **Pjetër Bogdani**, kërkimi retorik i të cilit për *Biblën* shënon

⁴ Dr. Ibrahim Rugova: *Kahe dhe premise të kritikës letrare shqiptare, 1504-1983*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1986, fq. 167.

⁵ Vehbi Miftari, *Maloki: Fryma nacionale në letërsi*, "Shpresa", Prishtinë, 2006.

shkallën e parë të kërkimeve teorike, si dhe të interpretimit letrar në letrat shqipe. Le të kujtojmë menjëherë: sipas teorisë së njohur mesjetare, Bogdani e rikthente kërkimin për interpretimin e *Biblës* në kërkim për esencat letrare, duke nënkuptuar atë që shën Jeronimi e cilësonte si *letra*, duke i rrafshuar kufijtë mes filozofisë e poezisë dhe, më tej, mes poezisë e shkrimit shenjtë.

Nëse ndërlihdja me krijimin e vetëdijes për kritikën në fillim të shekullit XX merret për kriter, shenjen e parë të kësaj literature e gjejmë te **Krist Maloki**, i lindur në Prizren, por i formuar në Graz të Austrisë. Tek ai janë shquar idetë letrare që nisin si burime në psikobiografi të shkrimtarit, për të mbaruar te botëkuptimet e tyre - herën e parë, dhe tek idetë nacionale - herën e dytë. Maloki - dialogues me metodat tematologjike e psikanalitike - e njëjtte ideologjinë e lexuesit e të tekstit nëpërmjet kërkimit psikobiografik të shkrimtarit. Nga kërkimi i shenjave të tekstit, Maloki preferonte kapërcimin në kërkim të ideve.

Vitet '50 njohin interpretimin e tekstit sipas kërkesave për trajtimin e saj si mjet për të pasqyruar realitetin shoqëror, premisë e njohur e teorive socrealiste, e artikuluar si program nga Dhimitër Shuteriqi. Duke qenë se kritika letrare në Shqipëri ishte institucionalizuar në një prerje të madhe të zhvillimit të saj dhe ideve e ideologjive politike, në Kosovë ajo nuk mund të zhvillohej pashkëputshëm, aq më tepër po të marrim parasysh kontekstualitetin e saj dhe sidomos tekstualitetin ose "objektin e munguar" të saj.

Esad Mekuli shpaloste programin e tij për një kritikë letrare "kombëtare për nga forma dhe socialiste për nga përmbajtja"⁶. Ai shkruante tekste kritike recensioneale. **Vehap Shita** i zgjeronte format e shkrimit, duke shkruar herë recensione e herë vështrime kritike.

Në **vitet '60** mendimi kritik nis e hapet ndaj shkollave të huaja, kryesisht të rendit ideologjik, duke mos e shënjuar kapërcimin ase tejkalimin e metodës së mbështetur në parime utilitare dhe në përmasën ideologjike në interpretim, por duke

⁶ Esad Mekuli, *Mbi letërsinë dhe punën letrare*, "Jeta e re", Prishtinë, nr. 1, 1949.

nënvizuar braktisjen e konceptit të ngurtë socrealist, të institucionalizuar si dije teorike në Shqipëri. Në këtë kohë, koncepti i ideologjizuar u shndërrua në koncept për letërsinë e për shkrimtarin e angazhuar dhe të lirë, sipas metodës së propozuar nga Sartri. Pas shkrimeve të **Ali Aliut, Rexhep Qosja** është i pari i cili solli këtë vetëdije për kritikën. Duke u mbështetur në parime universale të interpretimit, edhe pse pikëmbështetje për tekstet e tij mbetet ideologjia, ai ndërton një metodë të veçantë të kërkimit, i cili mbështetet në premisa kulturore e historike, duke e shfaqur metodën: kërkimin biografik kulturor e historik, një lloj i kërkimit të integruar në të cilin premisat jetësore e ato kritike shihen në të njëjtin rrafsh. Duke u mbështetur në parime dialektike, ai e hapi këtë metodë edhe ndaj modernes, deri atëherë të refuzuar. *Praxis*-i i tij kritik e tkurr në kërkimin për format e ideologjisë së pranishme në tekst, megjithëse krijoi një traditë të shtrirjes së kufijve të interpretimit, duke përgatitur terrenin për kërkime më të specializuara.

Vitet '70 përfundimisht e institucionalizojnë mendimin kritik në Kosovë dhe përgjithësisht në letrat shqipe. Tendanca për hapje të kritikës ndaj shkollave dhe metodave të reja kritike, është edhe objekt i debatit, herë të heshtur e herë tjetër të afishuar ndaj kritikëve të rinj, të cilët kërkonin hapjen e kritikës ndaj metodave të reja, si dhe përkufizimin e kritikës. Ajo që sot me termat zhenetian quhet *letërsi metatekstuale*, si vetëdije, është shfaqur pikërisht në vitet '70, kur krahas kritikës e metodave të saj, shfaqet tendanca edhe për përkufizimin e saj teorik.

Ibrahim Rugova shënon hapjen e parë të madhe ndaj shkollave e metodave kritike europiane dhe ikjen përfundimtare nga kërkimi kritik me parabazë ideologjike e sociale. Duke dialoguar me teorinë, ai synon interpretimin e tekstit si rezultat të leximit dhe jo si premisë teorike të aplikueshme në tekst. Rugova i synon përkufizimet e mëdha në letërsi, për ta lexuar pastaj letërsinë si institucion autonom dhe për t'i pranuar leximet shumëfishe, edhe pse kërkimi e shpinte më shumë nga teoretizimet sesa nga interpretimet. Duke dialoguar me teorinë e me metodat, ai ndërtoi një metodë të kërkimeve teorike, e cila ikën nga kronologjia dhe i kërkon tipologjizimet e mëdha.

Sabri Hamiti ikën nga skemat e leximit dhe i preferon variantet. Duke e institucionalizuar atë që Barti e quante *vdekje*

të autorit, ai i shihte tekstin letrar dhe atë kritik si *ligjërime të mundshme* dhe jo si *formula profetike*. Bashkë me Rugovën, ai araqet tipin e kërkuesit metatekstual i cili i afishon *leximet shumëfishe, variantet e leximit*, të cilat e nënkuptojnë edhe një moshë të leximit. Hamiti, për ndryshim nga Rugova, nuk i synonte përkufizimet teorike, por e lexonte dhe e shkruante tekstin kritik si *variant të mundshëm të interpretimit*. Kërkimet e tij përbëjnë edhe sot projekt të madh për letërsinë shqipe. Para tij, projekt të veçantë kritik shpallte Kuteli.

Mensur Raifi e lexonte traditën dhe bashkëkohësinë, duke i kërkuar përmes tyre shenjat e *leximit psikanalitik*. Ndryshe nga Maloki, Raifi i interpretonte tekstet e Nolit dhe të Migjenit, duke e shmangur psikobiografinë si qendër të origjinaritetit të tekstit dhe duke përcaktuar analizën e mitit modern me premisa të psikanalizës si qendër të krijimit letrar.

Në **vitet '80** u zhvillua një hapësirë e gjerë, e cila solli kërkues e tekste me përmbajtje heterogjene, jo vetëm në kuptimin e formave, por edhe të koncepteve teorike, por pa lënë shenjë të dukshme në asnjërën prej tyre. Në atë kohë, kritika u institucionalizua si *kërkim i mundshëm*, por përmasa e këtij kërkimi nuk e shtrinte rrezën e tij deri në teoretizime të mëdha. Në atë kohë, kërkimi u kthye kryesisht nëpër katedrat universitare, si dhe në periodikun letrar.

Vitet '90 mbase shënojnë periudhën më interesante të kërkimit kritik në Kosovë. Vetë-dija kritike në atë kohë e shpie kërkimin për modelet deri në modernitet, duke u identifikuar me një vetëdije për kritikën e me një shenjë të madhe të kulturës ambientale, të zhvilluar në vitet '30. *Rikujtesa kulturore* është pasuar me *ri-kujtesën tekstore* e kërkimore: autorë të përjashtuar e të ekskomunikuar janë objekt i kërkimit për të krijuar pasqyrën krijuese në letrat shqipe. Dija për kritikën tek autorët e kësaj periudhe është e derivuar dysojesh: nga rezultatet e kërkimit të pararendësve të viteve '70 - në njëërën anë, si dhe nga rezultatet e ofruara nga shkollat kritike e letrare europiane, deri te kritika e re amerikane, duke shënjuar hapjen totale ndaj ideve e ndaj metodës - herën e dytë. Kërkimet intertekstuale e intermediale janë shenjë e kryqëzimit të madh të kërkimit dhe e formimit të tyre në raport me shkollat e me rezultatet e kritikës europiane;

Kosova: Letërsia metatekstuale (Forma e Metoda)

Letërsia metatekstuale shqipe në Kosovë njih forma e metoda të ndryshme të kërkimit. Nëse shkrimeve të para kritike në letrat shqipe u përkasin shkrimet e shkurtra informative (shënimet) dhe recensionet e Konicës, këto zhanre do të jenë të pranishme në gjithë kritikën letrare shqipe, prandaj edhe në atë të Kosovës. *Projekt kritik*, ose studime të veçanta shkruan Qosja, Rugova, Raifi e Hamiti, duke e lidhur shenjëën e kërkimit me atë të pëlqimit për zhanrin. Formë tjetër e pëlqyer, e njohur në letrat shqipe nga **Lumo Skendo** (Mit'hat Frashëri) e këndeje ishte *monografia*, herën e parë e tipit biografik, kurse herë të tjera, sikur te Qosja, Rugova e Hamiti, e *tipit eseistik*, e cila e tejkalon skemën e kërkimit sipas tipit të monografisë klasike të Mit'hatit.

Pjetër Bogdani shkroi tekst të ligjëratës retorike e filozofike përmbi një tekst biblik, duke e strukturuar tekstin e tij sipas *tekstit-objekt*. Teksti i Bogdanit karshi e në krah me Biblën. Autori i tij, predikues e mbrojtës i vlerave të krishterimit, shndërrohet përnjëherë sipas tiparit mesjetar në njëjtësues tipash të shkrimit. Shkrimi kritik i vihet në krah shkrimit letrar, duke u njëjtësuar me të në nivel të strukturës, po aq sa të diskursit e të ideve. Ky tip interpretimi është i aplikueshëm në kritikë, duke u identifikuar sidomos me tipin e *kritikës së shkrimtarit* sipas tipologjisë tibodeane, në të cilën diskursi i autorit është i ngjashëm me diskursin e tekstit objekt, duke parapëlqyer edhe zhanrin: esenë e trajtesën.

Krist Maloki ka shkruar tekste të cilat i takojnë për nga forma tipit të *teksteve informuese*, çfarë i aplikonte Konica para tij, por për nga diskursi ato ngjajnë më shumë me tipin e *shkrimit të diskursit kulturor*. Me këto tekste ai synonte të jepte informacion për letërsinë shqipe, ndërkohë që planet tekstore kalojnë nëpër literaturë e në derivimin e saj për shkak të rrethanave ambientale. Rrjedhimisht, Maloki synonte të krijonte kontekstin e literaturës shqipe, para se të synonte interpretimin e saj.

Vitet '50 njohin kryesisht zhanrin e *recensionit* dhe, më tej, *kritikën e gazetave*. Rol parësor në zhvillimin e kësaj forme të kritikës mban periodiku dhe, më saktësisht, gazeta "Rilindja"

ase “Zani i rinisë”, në të cilat u krijua hapësirë “paraqitëse” për libra dhe autorë të ndryshëm, kryesisht të letërsisë bashkëkohore shqipe. Autorë si **Vehap Shita**, **Hasan Mekuli**, **Hilmi Agani** etj., japin sprovat e para të “institucionalizimit të zhanrit” në kritikën metatekstuale shqipe, edhe pse vënia në krizë dhe jo institucionalizimi i zhanrit, janë tipare të zhvillimit të kritikës.

Në **vitet '60** kërkimi kritik njih jo vetëm *recensionin*, por edhe *vështrimin kritik* dhe, më tej, *monografinë*, ose kërkimin biografik-letrar, sipas konceptit historik-letrar. **Rexhep Qosja** shkruan kryesisht tekste studimore e tekste të tipit monografik e historik letrar: qoftë kur shkruan tekst të veçantë për Naimin, qoftë kur jep premisat e një historie të letërsisë shqipe. **Ali Aliu** e kultivoi kryesisht *kritikën publicistike* ose *kritikën e gazetave*, si forma të kritikës, si dhe zhanrin dominues të saj: *recensionin*. Krahas kësaj, fushë e interesimeve të tij do të jenë kërkimet teorike, duke ndikuar në vetëdijen kritike të kohës. Sikur u tha tashmë, kjo periudhë njohu edhe *kërkimin monografik*: **Ali Jasiqi** botoi monografinë për Josip Relën, **Rexhep Qosja** atë për Naimin.

Vitet '70 shënuan hapjen e madhe të letërsisë metatekstuale shqipe ndaj shkollave e metodave, si dhe sollën një pluralizëm formash e metodash në kërkimet kritike. Hapja ndaj shkollave, si dhe numri i shtuar i teksteve letrare e i formave të saj, ndikuan në krijimin e një të mirëfilltet kritike letrare në Kosovë. **Mensur Raifi** shkruante kritikë sipas metodës psikanalitike në një dritë tjetër të kërkimeve nga ato të **Malokit**. Rendi i parashtrimit është i përkundërt, por ruan shenjat teorike e praktike të kritikës psikanalitike. Në tekstin e tij për Nolin e Migjenin ai shfaq shenja të kërkimit me parabazë teoritë psikanalitike. Duke ia nënshtuar premisat psikanalitike teorisë së mitit modern, ose antimitit, ai krijoi një metodë të veçantë në letrat shqipe, e cila parabazën mitike e shpie deri në modernitet të kërkimit kritik. Në kuptimin e formave, tekstet e tij dalin si vështrime kritike e si studime të veçanta, duke i zgjeruar kufijtë e shtrirjes formale në letrat shqipe. Të tilla janë tekstet e tij për poezinë dhe për prozën shqipe.

Ibrahim Rugova zgjodhi *esenë* për formë të parapëlqyer, duke insistuar se kritika letrare është aktivitet i shkrimtarit dhe se eseja është *formë e hapur* e cila lejon teoretizime duke

dialoguar po me teoritë, çfarë synonte veçan Rugova, ose për të interpretuar tekste e autorë të veçantë, çfarë synonte Hamiti. Eseja ishte aplikuar nga Konica dhe sidomos nga Kuteli e Maloki dhe përbënte *formën e zgjedhur* për shkrimin kritik (sikundër dihet letërsi të ndryshme zgjedhin formë të ndryshme), por megjithatë zhanër po kaq i njohur mbetet recensionin, i cili u kultivua së pari nga Konica. Më tej, *eseja* mbetet forma e zgjedhur e tij, si *kritikë e shkrimtarit*.

Sabri Hamiti dialogon me teoritë për të ndërtuar një sistem të vetin të leximit, i cili i njeh variantet, madje të diferencueshme nëpër kohë. Kërkimi i tij për një poetikë jo historike por të formave, të ideve dhe të vetëdijes letrare shqipe, shënon sprovën e parë të hetimit të shenjave të tekstit jo vetëm duke i njohur e pranuar variantet e leximit, por edhe të shkrimit, gjithnjë duke u dhënë atyre vulën e madhe të komunikimit personal me tekstin-et. Zhanri i tij i preferuar mbetet eseu, qoftë në shkrimet monografike për autorë të veçantë, Sulejmanin, Rrahmanin, Konicën e Xhaferrin, qoftë në tekstet interpretuese për autorë të ndryshëm të letërsisë shqipe.

Në **vitet '80** kërkimi për shenjat e literaturës solli atë që quhet *rikonsolidim i zhanrit*. Autorë të ndryshëm i zgjeruan më tej mundësitë e shkrimit kritik në zhanret e në format ekzistuese, sikundër që ndonjëherë u sprovuan edhe forma të reja të shkrimit kritik. Këto dy premisa mund të krijojnë pasqyrën për ekzistimin e kritikës dhe për komunikimin e saj me literaturën e me publikun: nga një shumësi tekstesh e autorësh, në një heterogjenitet formash e metodash; nga një hapësirë e zgjeruar e shkrimit në konsolidim të formave ekzistuese. Në kuptimin e metodës, kjo periudhë nuk shquan tendencën e përqafimit të modeleve ase të shkollave. Ajo mbledh dhe lejon praninë e tyre, pa e as përkufizuar teorikisht në plotni kërkimin teorik, por nuk dallon metodë që shënon prirje të institucionalizimit në kërkim.

Ramadan Musliu është shembull tipik i kësaj periudhe. Ai njohu dhe i aplikoi disa nga rezultatet e afishuara nga kritika letrare shqipe në Kosovë, por nuk u përqendrua në një tip të veçantë të kërkimit. Krahas tij, autorë të tjerë, si **Milazim Krasniqi**, **Basri Çapriqi** etj., dhanë disa rezultate kërkimi, duke filluar me shkrime recensionale kritike, për të përfunduar me

teorinë e vargut, apo në mënyrë inverse, nga mikro e makrostruktura e tekstit, pra nga teoria e vargut, në shkrime të herëpashershme kritike.

Në vitet '90 kërkimi e rikthen shenjën e madhe të kërkimit identitar për statusin e kritikës, si dhe kërkimin e përkatësisë në raport me dijet teorike përkufizuese evropiane e amerikane, në anën tjetër. Shenja identitare rikthehet përmes kërkimit të identifikimit me një vetëdije ekzistuese kritike, por edhe me një projekt të madh të mbështetur në paradigma nacional-kulturore. Duke ecur krahas e në vijë me një projekt të madh kulturor e politik të karakterit nacional, si dhe duke përjetuar rikthimin e autorëve të ndaluar ose zbulimin e autorëve të panjohur ase pjesërisht të njohur, si dhe duke stimuluar kërkimin që ecën tehtë të modernitetit transcendental ndër shqiptarë, kritika kërkoi identifikimin me këto transcendenca, të projektuara së pari në kulturë, përmes kërkimit të shenjave identitare nacionale, e pastaj në literaturë, në kërkimin për vlerat letrare e kritike.

Autor me të cilin nis aplikimi i këtij modeli kritik e kulturor në letrat shqipe, dhe veçmas në Kosovë, është Kujtim Rrahmani, doktor i letërsisë, i cili në tekstet e tij njeh kryesisht kërkimin e modeleve kulturore orale, transponimin e tyre në literaturën e shkruar dhe lidhjen e përhershme me shenjën e me vetë-dijen ambientale. Projekti për literaturën është i barasvlershëm me projektin për shpalosjen e shenjave të mëdha identitare të saj e për ndikimin e tyre në literaturën e një kombi, prandaj kërkimi i këtyre modeleve në veprën e disa nga autorët më të mëdhenj të letërsisë shqipe, sipas metodës së kërkimit intertekstual, është sprovë më e vyer, e cila projektin për idealitetin e theksuar kulturor e përfshinte në kërkim për modelet orale, si shenjë zanafillore letrare.

Studimi, ose forma akademike e kritikës, sipas përcaktimit të Tibodesë, që dialogon me teorinë, nga ato strukturaliste te ato poststrukturaliste e postmoderniste, është formë e parapëlqyer e tij dhe e brezit të tij, duke e shënjuar rikthimin e vetëdijes kritike, krahas vetëdijes për format e saj, të dyja derivate të vetëdijes kritike, të ushtruar në modernitetin e hershëm ose zanafillor, sikur e quajtëm në fillim.

Kosova: Letërsia metatekstuale (Tekste themelore)

Bogdani shkroi të parin tekst me shenja teoretizeuse dhe interpretuese në letrat shqipe. *Cunneus prophetarum* (Çetta e profetëve) është tekst i identifikimit të filozofisë me teologjinë, dhe më tej i filozofisë me poezinë, të aplikuar në interpretimin e Biblës si tekst letrar. Madje, jo vetëm interpretimi, por edhe struktura e synojnë një identifikim të tillë. Këtë identifikim studiuesi më i madh i veprës së tij, kërkuesi i identitetit nacional e i identifikimeve të mëdha me konceptet filozofike të Bogdanit, dr. Rugova e shihte përbrenda strukturës, duke interpretuar edhe relacionin e brendshëm mes tyre: “ide e strukturë” dhe “ide e mendim”. Teologjia aplikohet në sistem të shenjave, ndërsa e përkthyer në idenë për “qenien e pavarur” (*Ente indipendente*): Zotin, si dhe për praninë e tij, ndikon në ndërtimin e sistemit të të menduarit. Një formulë magjepsëse, e përsosur në identifikimin e diskursit e të përmbajtjes, si dhe një sprovë e shkëlqyer për të ndërtuar një strategji të komunikimit me tekstin. Pjesa e parë e *librit*, e identifikueshme me *Dhjatën e vjetër* ase me kosmogoninë, identifikohet si traktat filozofik, i cili teologjinë dhe filozofinë dëshiron t’i aplikojë si strukturë të mendimit përmbi një tekst letrar. Pjesa ka strukturë të pambyllur, për të përforcuar qëllimshëm idenë për tekstin, si tekst i hapur (Kujto konceptin e Bartit dhe të Ekos për *librin e hapur*). Pjesa e dytë ndërkaq, është e identifikueshme me *Dhjatën e re*, ose me tekstin i cili “rrëfen” jetën e Krishtit. Në kuptimin letrar, ai është aplikim praktik i ligjëratës filozofike e teologjike, të përmbledhur në pjesën e parë, duke krijuar modelin për letërsinë: tekstin si identifikimi me ideografinë e autorit.

Maloki dialogonte me metodat tematologjike e psikanalitike, duke e paracaktuar edhe tipin e kërkimit, *kritikën e kodeve tematike*, që e njëjtte ideologjinë e lexuesit e të tekstit, përmes kërkimit psikobiografik të shkrimtarit. Kritika tematike e sfondit romantik dhe kritika psikobiografike e Frojdit në tekstet e tij i nënshtroheshin kriterit të ideologjisë nacionale. Nga ndërvoja kalohet në vetëdije, për t’iu kthyer përherë e gjithnjë kërkimit të frymës nacionale në letërsi, si preferencë edhe për farën e letërsisë: *letërsi e frymës nacionale*. Autor i teksteve në

esencë polemizuese, Maloki i shkroi dy tekste të cilat në kuptimin e formave dalin si kritikë e specializuar, *Naim Frashëri dhe A asht poet Lasgush Poradeci?*. Më duket se Maloki ia parashtronte kritikës tipin e kërkimit psikanalitik e tematologjik në kohën kur letërsia shqipe mbisundohej nga ideja nacionale e nga kërkesa për frymën e saj në letërsi. Kritika letrare e Krist Malokit niste në kohën kur te shqiptarët projekti nacional ishte ende projekt themelor i etnisë e i kulturës. Formimi kritik i Malokit duket të jetë “diçka e përbashkët” mes psikanalizës dhe tematologjisë, ose mes kritikës së *vizionit të autorit*, kritikës tematologjike dhe asaj të *ndërdijes së tij*, kritikës psikanalitike.

Rexhep Qosja është autor i monografisë për Naim Frashërin, si dhe shkruet i *Historisë së letërsisë shqipe – Romantizmi*, në tri vëllime. Sipas metodës biografike, pra historike-kulturore, ai shpjegoi formimin dhe rolin e autorëve përfaqësues të Romantizmit në letërsinë shqipe.

Ibrahim Rugova është kërkues i shenjave teoretizuese në letërsinë shqipe, po aq sa edhe sistemues i madh në kërkim e në interpretim. Në rrafshin e parë, atë të përkufizimeve të mëdha teorike, kërkimi më i madh i dr. Rugovës mbetet *Kahe dhe premisa...*, kurse në fushë të kërkimit kritik studimi shumplanësh për Bogdanin, *Vepra e Bogdanit*, tekst i cili prek strukturën sikur edhe statusin e tekstit, duke e riaktualizuar vazhdimisht leximin e kërkimin.

Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqipe, sikur u tha, është kërkimi më i madh në fushë të përkufizimeve të mëdha teorike, e cila pason tekstet *Kah teoria dhe Strategjia e kuptimit*. Teksti synon të japë një përshkrim të zhvillimit të kritikës letrare shqipe, si dhe të komunikojë me rezultatet e saj, tash nga pozicioni i komentuesit. Një lloj metatekstualiteti kritik, i cili sipas formulës dualiste bogdaniene, mund të përmblihet në *tekste përshkruese dhe tekste komentuese* për nga natyra. Në të Rugova ofron një pasqyrë kronologjike të kritikës letrare shqipe, duke përmbushur kërkimet për bibliografinë e kritikës, sikur që ofron gjykimin e tij të pavarur dhe më të plotë deri tani për kritikën letrare shqipe nga fillimet e saj e deri në vitet '80 të shekullit të kaluar.

Vepra e Bogdanit, ndërkaq, shënon shkallën e tretë të identifikimeve strukturore e poetike: atë të tekstit të Rugovës

karshi tekstit të Bogdanit, i cili, sikur u tha, është shkruar sipas analogjive biblike. Rugova e situon kërkimin në dy rrafshe: gjenetikën e veprës dhe analitiken e tekstit, duke ruajtur idenë për kosmogoninë dhe jetën praktike të Jezu Krishtit në tekstin biblik, ose të traktatit filozofiko-teologjik, në pjesën e parë, dhe të praktikës letrare, në pjesën e dytë të tekstit të Bogdanit. Dikursi i tekstit të Rugovës, prandaj, është diskursi i tekstit a i koncepteve të autorit që interpretohet, duke nënkuptuar leximin në një kohë tjetër dhe duke synuar identifikimin me të, në nivel të diskursit po aq sa edhe në nivel të metodës. Duke ruajtur strukturën e tekstit të Bogdanit në tekstin interpretues, Rugova bën përshkrim të koncepteve dhe komentim të tyre, duke i hetuar shenjat e sistemit të Bogdanit. Rrjedhimisht, kërkimi e gjedh metodën: kërkimin e strukturave sipas metodës strukturale dhe kërkimin e shenjave të sistemit sipas metodës semiotike. Një model i tillë i kërkimit struktural/semiotik, paraqet metodën e aplikuar të Rugovës në tekstin për Bogdanin.

Sabri Hamiti shkroi tekste të ndryshme nën moton “sprovë për një poetikë”, duke eksplikuar metodën e kërkimit: leximin e tekstit, i cili është personal, prandaj edhe i mundshëm, si dhe variantin e leximit, ose ikjen nga ideologjia për t’u kthyer te përhershmeritë letrare. Nga *Variante te Letra shqipe*, ai kërkon ikjen nga metodologjia skematizuese dhe përqafon lirinë e leximit, sprovën, që nënkupton një mundësi interpretimi e komunikimi me tekstin e me autorin. Kërkimi përmbillet me *Bioletrën*, e cila është një teori personale e shkrimit dhe e leximit, pra një tekst i cili i synon përkufizimet teorike, po aq sa edhe shkrimin si akt i komunikimit të subjekteve. Por, normimi teorik nuk synon të vihet si kurorë për shkrimin, i cili synon kthimin dhe mbetjen të liria personale, ajo është rezultat, por jo kornizë.

Kujtim Rrahmani, shkroi kurorën e kërkimit, *Itertekstualiteti dhe oraliteti – Kuteli, Koliqi, Fishta*. Meqë distanca kritike është e domosdoshme për gjykim objektiv, po mjaftohemi me këtë përkufizim.

Përmbyllje

Sikundër u provua, tekstet themelore të letërsisë metatekstuale në Kosovë, së paku të fundviteve të shekullit XX, kur kritika letrare u rikthehet parimeve të përcaktuara qysh në fillim të shekullit XX, janë të lidhura pashkëputshëm me lindjen e *modelit kritik*, çfarë përfaqësonte veçan Konica, Maloki, Kuteli etj., duke krijuar një kthim të vazhdueshëm në shenjat e modernitetit kritik, si dhe në kërkimin e modeleve. Meqë kritika letrare në Kosovë lindi dhe u zhvillua në një kontekst paksa të ndryshëm social e kulturor nga ajo në Shqipëri, ajo njohu faza të përafërimit me kodet e soçrealizmit, duke afishuar kritikën biografike-letrare, pastaj hapjen e madhe ndaj shkollave e metodave, institucionalizimin e kritikës, por duke njohur heterogjenitetin si esencë derisa, në fund, në vitet '90 u rikthehet përnjëherësh kodeve të mëdha kulturore e letrare, duke njohur e përqaftuar dijet për letërsinë si kthim në esencat e kërkimit.

Bibliografia

- Bogdano Pietro, *Cuneus Prophetarum...*, Patavii, 1685.
 Hamiti Sabri Dr., *Vepra letrare 1-10*, Faik Konica, Prishtinë, 2002.
 Maloki Krist *A asht poet Lasgush Poradeci?*, "Përpyekja Shqiptare", Tiranë, 1938, 1939.
 Maloki Krist, *Refleksione - kritikë letrare, analiza dhe mendime*, (përgatiti: Albert Ramaj), Faik Konica, Prishtinë, 2005.
 Mekuli Esad, *Mbi letërsinë dhe punën letrare*, "Jeta e re", Prishtinë, nr. 1, 1949.
 Miftari Vehbi, *Maloki: Fryma nacionale në letërsi*, "Shpresa", Prishtinë, 2006.
 Rugova Ibrahim Dr.: *Kahe dhe premise të kritikës letrare shqiptare, 1504-1983*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1986.
 Rugova Ibrahim Dr.: *Vepra e Bogdanit 1675-1685*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 77.
 Raifi Mensur, *Fan Noli dhe Migjeni*, Rilindja, Prishtinë, 1975.
 Rrahmani Kujtim, *Intertekstualiteti dhe oraliteti, Kuteli, Koliqi, Pashku*, AIKD, Prishtinë, 2001.